

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë) ☐

INSTANT.AL

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L81506043D

NUIS/NIPT

Rr. Ali Demi perballe Fushes se Zeze , Tirane, Tirane zona kadastrale 8150 ,numri i pasurise 8/801-
Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0688453057

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

emerlindagjana01@gmail.com

E-mail

Administrator Emerlinda Gjana

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2025/06/07

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0688453067

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-49864-06-02-2025

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Mirdite

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

1583333

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje kompjutera dhe paisje kompjuterike , bashkia Mirdite

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2025/06/16

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2025/06/16

Numri i njoftimit

REF-49864-06-02-2025

Kodi CPV

30237200-1

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar

2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit ☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj. ☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. ☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Autoriteti kontraktor Bashkia Mirdite më datë 03.06.2025, ka publikuar në sistemin elektronik të APP-së procedurën “E hapur, e thjeshtuar”. Me objekt: “Blerje kompjutera dhe paisje kompjuterike , bashkia Mirdite” me fond limit 1.583.333, (Një milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre.) lekë pa TVSH me REF-49864-06-02-2025

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Ne, si operator ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga Bashkia Mirditë, paraqesim këtë ankesë në përputhje me nenin 105 të Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik , për arsye se dokumentacioni standard i tenderit përmban kushte diskriminuese dhe të pajustifikuara teknikisht, të cilat përbëjnë pengesë të padrejtë për pjesëmarrjen tonë dhe të shumë operatorëve të tjerë në mënyrë të barabartë.

Përpara argumentimit të shkeljeve të pretenduara nga ana jonë dëshirojmë të bëjmë një përshkrim të shkurtër të shoqërisë sonë e cila në thelb të krijimit të saj ka të bëjë drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit por që nuk është e orgaizuar vetëm për procedurat e prokurimit publik por ka një klientelë të madhe sa i takon klientëve privat.

Prej vitit 2018 ushtojmë veprimtarinë tonë në fushën e programimit IT, dhe duke vendosur në projektivin tonë ndërtimin e faqeve të webit, sisteme jemi profesionalizuar në këtë fushë duke sjellë për herë të parë në Shqipëri alterantivat interaktive sa i takon përshtatjes së një faqeje webi me sistemet e ndërlidhura.

I. Shkelje në përcaktimin e emrave tregtarë specifike

Në dokumentet e tenderit janë përcaktuar emrat konkretë të produkteve të mëposhtme:

1. Cloud Gateway Firewall UDM Pro
2. Switch USW-24 Standard

Të dy këto produkte janë pajisje specifike të prodhuara nga kompania Ubiquiti, dhe për më tepër përfshihen me emër tregtar, duke mos u lejuar operatorëve të ofrojnë pajisje ekuivalente.

Sipas nenit 33, pika 4 të Ligjit për Prokurimin Publik:

“Autoritetet kontraktore nuk duhet të përshkruajnë një produkt të caktuar duke përdorur markë tregtare, patentë ose origjinë të caktuar, përveç rasteve kur përshkrimi i objektit të kontratës nuk mund të bëhet ndryshe dhe gjithmonë duhet të shoqërohet me fjalët ‘ose ekuivalente’.”

Në rastin konkret:

? Përdorimi i emrave “UDM Pro” dhe “USW-24 Standard” pa shtesën “ose ekuivalente” përjashton në mënyrë të padrejtë operatorët që mund të ofrojnë pajisje nga marka të tjera që përmbushin të gjitha specififikimet teknike.

? Nuk ka asnjë justifikim teknik në dokumentacion përse këto pajisje janë të vetmet që

plotësojnë nevojat e Bashkisë.

II. Kërkesa për autorizim nga prodhuesi, edhe kur objekti është një njësi
Në seksionin “Kërkesat për dokumentacionin teknik” është përcaktuar se:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori?”

Kjo kërkesë aplikohet për produkte ku sasia është vetëm 1 copë.

Ky kusht është i papërshtatshëm dhe jo proporcional sipas nenit 38, pika 1, të Ligjit për Prokurimin Publik, ku thuhet:

“Kriteret që vendos autoriteti kontraktor duhet të jenë të ndërlidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe të jenë proporcionale me natyrën dhe vlerën e saj.”

Në këtë rast, për një njësi të vetme, një kërkesë e tillë:

? E përjashton operatorët e vegjël ose të mesëm të tregut që furnizojnë produkte origjinale, por që nuk janë shpërndarës të autorizuar të nivelit të parë.

? Krijon avantazh të padrejtë për një ose dy kompani në treg, që kanë marrëveshje direkte me prodhuesin Ubiquiti.

III. Specifikimet teknike nuk janë të përgjithshme dhe diskriminojnë operatorët

Specifikimet teknike të përfshira në tender:

? Janë të përshtatura sipas katalogut të vetëm një prodhuesi (Ubiquiti).

? Nuk janë në përputhje me udhëzimet dhe praktikat standarde të miratuara nga AKSHI, ku zakonisht për pajisje firewall ose switch jepen kriteret të përgjithshme teknike, duke lejuar konkurrencë mes markave të ndryshme si Fortinet, Cisco, Mikrotik, Aruba, HPE, etj.

IV. Kërkesa e pajustificuar për autorizim për shërbimin e hostimit dhe domain

Në dokumentet e tenderit kërkohet autorizim prodhuesi edhe për shërbimet e hostimit dhe domain-it. Kjo është në kundërshtim me logjikën e tregut të lirë, pasi këto shërbime ofrohen nga shumë ofrues ndërkombëtarë dhe vendorë të licencuar, përmes partnerëve ose platformat online. Nuk ekziston një “prodhues” i vetëm për këto shërbime dhe autorizimi nuk është as teknikisht, as ligjërish i domosdoshëm për këtë kategori prokurimi.

V. Përfundime dhe kërkesa

Bazuar në arsyet e mësipërme, kërkojmë që:

1. Të hiqet çdo referencë ndaj emrave tregtarë “UDM Pro” dhe “USW-24 Standard” nga dokumentet e tenderit dhe të zëvendësohen me përshkrime teknike neutrale që pasqyrojnë kërkesat reale funksionale;
2. Të shtohet fraza “ose ekuivalente” në çdo përshkrim të pajisjeve;
3. Të rishikohet kërkesa për autorizim nga prodhuesi, veçanërisht për sasi minimale (1 copë) dhe për shërbime që nuk e justifikojnë atë (si hosting/domain);
4. Të rishikohen të gjitha specifikimet teknike dhe të përshtaten me modelin e AKSHI-t, në mënyrë që të sigurohet konkurrencë reale dhe jo diskriminim i operatorëve ekonomikë.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme ☐

Po ☐

Jo ☒

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

jo

7. Lista e informacionit konfidencial: ☐

jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes. ☐

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

emerlindagjana01@gmail.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Emerlinda Gjana